



SHPLLJE PËR FURNIZIME DHE SHËRBIME

AKP e cila ka në Administrim të Drejtpërdrejtë Ndërmarrjen Shoqërore “Inex Sharr Planina ” Brezovicë
SHPLLË këtë:

FTESË PËR OFERTË

I. LËNDA E KONTRATËS

Shpallje publike për furnizimin me mallra sipas specifikacioneve të mëposhtme:

LLOT 1 - NDËRRIMI I DRITAREVE TE HOTEL MOLIKA

Ky aktivitet përfshin blerjen dhe montimin e 70 dritareve me karakteristikat si ne vijimMateriali PVC, profili 8.5cm, 3 shirita gome, 2 xhama, solare, një krahësh me kiper, 7 hapësira, mekanizmi winkhaus, Ngjyra e dritareve, Antracit ana e jashtme, E bardhë ana e brendshme, Përmasat e dritareve 120cm x 120cm
Buxheti maksimal i paraparë për këtë aktivitet 16,000.00 Euro

LLOT 2 - FURNIZIMI ME DYSHEK, JASTAK, ÇARSHAF DHE JORGANA

Ky aktivitet përfshin blerjen e 200 shtretërve dhe elementet përcjellëse si jastak, çarçafë dhe jorgan.
Karakteristikat teknike :
Dyshekët duhet të jenë të kualitetit minimal aloe vera me dimensione 90 x 200 cm, për cdo dyshek duhet të përfshihet edhe furnizimi me 1 jastak me pendla, 1 çarçaf, 1 jorgan, 1 tepih (Çarshaf) shtrati që nuk e absorbon ujin.
Buxheti maksimal i paraparë për këtë aktivitet 14,000.00 Euro

LLOT 3 - FURNIZIMI ME TELEVIZOR

Ky aktivitet përfshin:
Furnizimin me 40 televizorë me diagonale 40” dhe mbajtëse muri për televizor
Furnizimi me 2 televizorë me mbajtës muri për televizor me diagonale 65”
Garancioni i televizorëve duhet të jetë 2 vite.
Buxheti maksimal i paraparë për këtë aktivitet 7,300.00 Euro

LLOT 4 – FURNIZIMI ME TEPISON DHE STAZA TE HOTEL MOLIKA

Ky aktivitet përfshin furnizimin me tepison dhe staza:
Tepisoni i rezistueshëm ndaj ujit për restorant, ngjyrë vishnje (bordo)
Stazat e rezistueshme ndaj ujit për korridor, ngjyrë vishnje (bordo)
Tepisoni për dhoma dhe korridor në katin 3 të cilësisë së kënaqshme, ngjyrë hiri
Sasia e kërkuar për tepisonin në restorant dhe stazat në korridor është **443 m²** ku përfshihet staza e gjerësisë 1.5 metra dhe gjatësi **55.66** metra totali **83.50 m²** stazë dhe **360 m²** tepison.
Sasia e kërkuar për tepisonin për dhoma dhe korridor në katin 3 është **438 m2**
Sasia e kërkuar për tepisonin për dhoma dhe korridor në katin 4 është **438 m2**. Sasia totale e tepisonit dhe stazave për blerje është **1,319 m²**.
Buxheti maksimal i paraparë për këtë aktivitet 7,500.00 Euro

LLOT 5 – VESHJA E HAPËSIRAVA TË PËRPARME TE RECEPTIONI DHE BANAKU TE HOTEL MOLIKA

Veshja e receptionit dhe banakut me materiale dekorative
Materialet duhet të jenë nga njëra anë nga materialet nga mahagoni dhe tjetra nga materialet kompensatë (iverica).
Buxheti maksimal i paraparë për këtë aktivitet 4,000.00 Euro

LLOT 6 – VESHJA (TAPECERIMI) I SHTRETËRVE TE HOTEL MOLIKA

Ky aktivitet përfshin veshjen (Tapeceimin) e 156 shtretërve
Pëlhurës e nevojshme për veshjen e një shtrati është 4 m² dhe duhet të jetë e cilësisë së mirë dhe të jetë ngjyrë kafe apo ndonjë ngjyrë tjetër të mbyllët
Syngjeri duhet të jetë me trashësi 2 mm,
Buxheti maksimal i paraparë për këtë aktivitet 5,000.00 Euro

LLOT 7 - NDËRRIMI I DYERËVE TË HYRJES TE HOTEL MOLIKA

Ky aktivitet përfshin blerjen dhe montimin e dy dyerve të hyrjes në Hotelin Molika Profili 8.5cm, 3 shirita gome Antracit edhe jashtë edhe brenda, 2 xhama, solare, mekanizmi winkhaus, 7 hapësira Dyer 2 copë, përmasat 345cm x 205cm
Buxheti Maksimal 2,800.00 Euro

LLOT 8 - FURNIZIMI ME PERDE

Nevojiten perde për gjithsej 80 dhoma.
Dimensinoni i perdeve të bardha apo me ngjyrë bezh, me copë: 150 cm gjerësi x 140 cm gjatësia,
Dimensinoni i perdeve anësore (drapera) për të dy anët me ngjyrë të gjelbërt, me copë: 45 cm x 3 gjerësia, 140 cm gjatësia.
Buxheti maksimal i paraparë për këtë aktivitet 1,900.00 Euro

LLOT 9 – RREGULLIMI I NDRICIMIT

Duhet të bëhet ndriçimi në restorant, korridor, në katin përdhes dhe në vet hyrjen kryesore të hotelit. Duhet të ndërrohen llambadarët ekzistues dhe poçet. Ndriçim i improvizuar në formën e dritave të tavanit duhet të përshtatet me enterier dhe duhet të vendoset ndriçim i ri në Hyrje të Hotelit, Reception, Banak dhe te restoranti te Hotel Molika.
Buxheti maksimal i paraparë për këtë aktivitet 1,000.00 Euro

Kërkesat teknike për operatorin ekonomik:

Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar në Republikën e Kosovës
Duhet të ketë përvojë në furnizime dhe shërbime të ngjashme – Referencat.
Periudha për kryerjen e këtyre furnizimeve për llot 1; 2; 3; 5; 6 është 15 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Periudha për kryerjen e këtyre furnizimeve për llot 4; 7; 8 dhe 9 është 10 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Operatori ekonomik fitues do të shpallet ai i cili i plotëson kriteret teknike dhe oferton me çmimin më të ulët.

AFATI KOHOR DHE VENDI PËR DORËZIMIN E OFERTAVE

Për Llot 1 dhe 2 për tu njohur më afër me aktivitetet që do të kryhen Operatorët ekonomik mund të bëjnë vizitë te Qendra e Skijimit në Brezovicë çdo ditë punë nga data **23.11.2023 deri më 03.12.2023**.

Për Llot 3; 4; 5; 6; 7; 8; dhe 9 për tu njohur më afër me aktivitetet që do të kryhen Operatorët ekonomik mund të bëjnë vizitë te Qendra e Skijimit në Brezovicë çdo ditë punë nga data **23.11.2023 deri më 28.12.2023**.

Për Llot 3; 4; 5; 6; 7; 8; dhe 9 ofertat finale të cilat duhet të jenë në zarf të mbyllur, duhet të dërgohen më datën **29.11.2023** nga ora **13:15** deri në orën **14:15** në adresën e mëposhtme:
Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. Dritan Hoxha nr. 55, 10000 Prishtinë.
Ofertat do të hapen me datën **29.11.2023** në ora **14:20** në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, rr. Dritan Hoxha nr. 55, 10000 - Prishtinë.

Për Llot 1 dhe 2 ofertat finale të cilat duhet të jenë në zarf të mbyllur, duhet të dërgohen më datën **04.12.2023** nga ora **13:15** deri në orën **14:15** në adresën e mëposhtme:
Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. Dritan Hoxha nr. 55, 10000 Prishtinë.
Ofertat do të hapen me datën **04.12.2023** në ora **14:20** në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, rr. Dritan Hoxha nr. 55, 10000 - Prishtinë.

Operatorët ekonomik mund të ofertojnë për të gjitha llotet por ofertat duhet të jenë të ndara për çdo llot.

V. Përfaqësuesit legjitim të ofertuesve, mund të marrin pjesë me rastin e hapjes së ofertave.